




2-D /DPK/

01-443/2012

02

01.02.2012



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.01.2012, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK– 03-3337/11, për z. **UKË RUGOVA** – *Deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.*

**II. Rasti mund të rihapet** në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e Funksionit Publik** me numër protokoli AKK-03-3337/11, për Zyrtarin e Lartë, Ukë Rugova – Deputet në Kuvendin e Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, që buronte nga ushtrimi i njëkohësishëm i dy posteve, si Deputet në Kuvendin e Kosovës, në njëren anë, dhe ushtrimi i funksionit drejtues të biznesi privat, “Zero8” sh.p.k (person i autorizuar), në anën tjetër, Zyrtari të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 09.08.2011.

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë, i është përgjigjur brenda afatit ligjor dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë ai është njoftuar për veprimet e mëtutjeshme dhe për mënyrën se si duhet shmangur situatën e dy funksioneve të njëkohshme, të papajutshme me ligj, në të cilën ai ndodhej.

Zyrtari i Lartë kishte premtuar se brenda perudhës së shkurtë kohore do të bëjë ndryshimet e kërkuara, por, në pritje të atyre ndryshimeve, Agjencia ka qenë e detyruar që Zyrtarit të lartë t'i bëjë edhe shkresën e dytë – paralajmëruese (me datën 29.12.2011) me të cilën pastaj i është dhënë afati i caktuar ligjor për të sjell ndryshimet e nevojshme mbi të drejtat e drejtimit të

bisnesit, që Zyrtarit të Lartë i shkaktonin gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kështu, me datë 30.01.2012, Zyrtari i Lartë, Ukë Rugova në Agjencinë kundër Korrupsionit ka sjellë Informatat mbi biznesin (D.P./DPKI), 03-387 / 2012), të lëshuara nga Agjansioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, në të cilat shihet se Ukë Rugova nuk ka funksion menaxhues në ndërmarrje dhe se ndryshimet të personat e autorizuar tashmë janë bërë, konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

Përfundimisht me marrjen e shkresës "Informata mbi biznesin" nga Zyrtari i Lartë, të lëshuara nga ARBK-ja dhe të protokoluara në AKK me numër: D.P. / DPKI, 03-387.2012, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

